



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
DREJTORIA E SUBJEKTEVE ZGJEDHORE, MBIKQYRJES, FINANCIMIT
DHE MONITORIMIT

NJOFTIM

RISHPALLJE APLIKIMI SI EKSPERT KONTABËL TË LICENSUAR (AUDITUES LIGJOR) PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE SHPENZUARA NGA PARTIA POLITIKE SOCIALDEMOKRATE PËR VITIN KALENDARIK 2023, SI DHE NGA SUBJEKTET ZGJEDHORE PARTIA REPUBLIKANE DHE PARTIA FRYMA E RE DEMOKRATIKE PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes këtij njoftimi, bën thirrje publike për shfaqje interesi për të qenë ekspert kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partia politike Socialdemokrate për vitin kalendarik 2023, si dhe subjektet zgjedhore Partia Republikane dhe Partia Fryma e Re Demokratike për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024.

Ekspertët kontabël të licensuar (audituesit ligjor), përveç kushteve të përgjithshme të ushtrimit të profesionit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duhet të plotësojnë njëkohësisht edhe kriteret e mëposhtme:

- a. Të ushtrojnë profesionin e ekspertit kontabël të licensuar (audituesit ligjor) për jo më pak se 5 (pesë) vitet e fundit;
- b. Të mos kenë marrë masa disiplinore në fuqi;
- c. Të mos jenë anëtar të ndonjë partie politike në 5 (pesë) vitet e fundit;
- d. Të mos kenë qenë kandidat të mbështetur nga ndonjë parti politike, koalicion apo kandidat i propozuar nga zgjedhësit në 2 (dy) zgjedhjet e fundit;
- e. Prindërit, bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhor të mos jenë anëtarë të partisë politike objekt i auditimit.

Aplikantët duhet të dorëzojnë brenda datës 22.4.2025 në mënyrë elektronike në email-in Persi.Dervishi@kqz.gov.al ose fizikisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dokumentat si më poshtë vijon:



- a. Kopje të noterizuar të licencës të ekspertit kontabël të licensuar (auditues ligjor), lëshuar nga IEKA, e vlefshme për vitin kalendarik respektiv;
- b. Vërtetim nga IEKA që vërteton se eksperti kontabël i licensuar (audituesi ligjor) ka jo më pak se 5 (pesë) vite eksperiencë dhe se nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- c. Fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- d. Deklaratë vetjake se nuk është në kushtet e parashikuara në shkronjat “c” dhe “d” të sipërcituara, sipas formatit të miratuar në shtojcën 1 bashkëlidhur udhëzimit nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë viti kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”;
- e. Raport mjeko-ligjor;
- f. Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Pas përfundimit të periudhës së aplikimit, sektori përgjegjës për verifikimin e aplikantëve që dorëzojnë dokumentacionin realizon, brenda 5 (pesë) ditëve, verifikimin e plotësimit të kriterëve formale të sipërcituara. Pas verifikimit dhe përzgjedhjes së aplikantëve që plotësojnë kriteret e sipërcituara Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nxjerr njoftimin për hedhjen e shortit për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesit ligjorë), të cilët do të auditojnë fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga partia politike Socialdemokrate për vitin kalendarik 2023, si dhe subjektet zgjedhore Partia Republikane dhe Partia Fryma e Re Demokratike për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024.

